

Gjykata Administrative

(Administrata Gjyqësore) AGJ-01. nr. 0102-37/19

Kryetari i Gjykatës Administrative, në bazë të nenit 88 dhe 92 i Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 58/2006; nr. 35/2008 dhe nr. 150/2010), lidhur me nenin 7 paragrafi 1 alineja 4 të Rregullores së gjykatës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 66/2013 dhe nr. 114/2014), pas seancës së mbajtur të gjykatësve, më 27.12.2019, e miratoi:

PROGRAMIN E PUNËS SË GJYKATËS ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2020

Me këtë program përcaktohen punët dhe detyrat e veprimtarisë së Gjykatës Administrative, sidomos lloji dhe numri i lëndëve për të cilat gjykata vepron, punët dhe detyrat në aspekt të ndjekjes dhe studimit të problemeve që dalin nga praktika gjyqësore, e që janë në interes të znatimit të rregullt dhe të vetëm të ligjeve, etj.

Nëpërmjet caktimit të punëve dhe detyrave që janë në kompetencë të kësaj gjykate, në kryerjen e funksionit gjyqësor të vërtetuar me Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, sigurohet zbatimi i së drejtës dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Qëllimet dhe funksionet e vërtetuara me këtë Program përfshijnë:

1. Zgjidhjen cilësore dhe në kohë të lëndëve që janë në kompetencë të Gjykatës;
2. Mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut;
3. Zbatimin e paanshëm të së drejtës, pa marrë parasysh pozicionin dhe cilësinë e palëve;
4. Sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve që çdo njeri të jetojë i sigurt, në suazat e zbatimit të së drejtës;
5. Përgatitjen e analizave, informacioneve, gjetjeve, etj., që do të ndihmojnë në zbatimin e duhur të së drejtës;
6. Takime dhe këshillime të organizuara nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik, në lidhje me edukimin e gjykatësve dhe nëpunësve gjyqësor, nga Shoqata e Gjykatësve, si dhe nga autoritetet dhe organizatat tjera.

Gjatë përgatitjes së Programit të punës për vitin 2020, në Gjykatën Administrative në Shkup janë plotësuar gjithsej 32 vende të gjykatësve, përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës, nga gjithsej 33 vende të parapara, përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës, sipas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë. Në të vërtetë, gjatë korrikut të vitit 2019, një prej gjykatësve të cilit i pushoi funksioni i gjykatësit në Gjykatën Administrative, për shkak se u emërua kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative, i njëjti vazhdoi ta kryejë funksionin e gjykatësit në Gjykatën Administrative, ndërsa në fund të

dhjetorit të vitit 2019, njërit nga gjykatësit të cilit i mbeti pezull funksioni i gjykatësit në Gjykatën Administrative, për shkak se u emërua anëtar i Këshillit Gjyqësor, i njëjti vazhdoi ta kryejë funksionin e gjykatësit në Gjykatën Administrative, kurse një gjykatësit i mbetet pezull funksioni i gjykatësit në Gjykatën Administrative, pasi është emëruar kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative.

Gjatë korrikut të vitit 2019, me Vendim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 02-1208/1 datë 12.7.2019, me të cilin shfuqizohet vendimi për lënien pezull të funksionit të një gjykatësi të Gjykatës Administrative, nr. 02-1253/1 datë 15.7.2015, një gjykatës, që nga 11.7.2019, vazhdon ta kryejë funksionin gjyqësor të gjykatësit në Gjykatën Administrative.

Gjatë nëntorit të vitit 2019, me Vendim për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë Administrative, nr. 08-1598/1 datë 3.10.2019 dhe Vendim për lënie pezull të funksionit gjyqësor, nr. 02-1826/1 datë 12.11.2019, që të dy të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një gjykatësit i është vërtetuar lënia pezull e funksionit gjyqësor në këtë gjykatë për shkak të emërimit si kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative, deri në përfundimin e mandatit për të cilin është përzgjedhur si kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative.

Në fund të dhjetorit të vitit 2019, me Vendim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 02-2067/3 datë 19.12.2019, me të cilin shfuqizohet vendimi për lënie pezull të funksionit gjyqësor të një gjykatësi në Gjykatën Administrative, nr. 07-2220/1 datë 30.12.2019, një gjykatës që nga 27.12.2019 vazhdon ta kryejë funksionin gjyqësor të gjykatësit në Gjykatën Administrative.

Në fund të dhjetorit të vitit 2019, janë përzgjedhur 2 (dy) gjykatës të Gjykatës Administrative, në bazë të Vendimit për zgjedhjen e gjykatësit të Gjykatës Administrative, nr. 08-1599/1 datë 3.10.2019, dhe Vendimin për përzgjedhjen e një gjykatësi të Gjykatës Administrative, nr. 08-1600/1 datë 3.10.2019, të dy të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Që nga dita e miratimit të këtij programi, në Gjykatën Administrative janë të punësuar: 65 nëpunës gjyqësor, 4 (katër) pjesëtarë të policisë gjyqësore dhe 2 (dy) punonjës që kryejnë punë teknike. Njëkohësisht, gjatë vitit 2019 është zbatuar procedurë punësimi për 11 (njëmbëdhjetë) nëpunës me kohë të caktuar, përfshirë 31.12.2019.

Në fillim të shkurtit të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi pa shpallje publike, me anë të transferimit të përhershëm, realizoi punësimin e 2 (dy) nëpunësve profesionalë gjyqësorë, edhe atë, 1 (një) këshilltar gjyqësor nga Ministria e Shëndetësisë dhe një bashkëpunëtor të ri gjyqësor nga Agjencia e Akreditimit të Cilësisë së Ushqimit.

Gjatë majit të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi pa shpallje publike, me anë të transferimit të përhershëm, realizoi punësimin e 1 (një) ndihmësnëpunësi gjyqësor në arkivin e gjykatës, edhe atë referent i lartë gjyqësor-zbatues në arkivin e Gjykatës Themelore Kumanovë.

Gjatë korrikut të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi me shpallje publike, realizoi punësimin e 3 (tre) nëpunësve gjyqësorë, edhe atë 2 (dy) nëpunës profesional gjyqësor me thirrje bashkëpunëtor i lartë gjyqësor dhe bashkëpunëtor gjyqësor, si dhe 1 (një) ndihmësnëpunës profesional gjyqësor me thirrje referent i lartë gjyqësor-zbatues në arkiv.

Gjatë shtatorit të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi me shpallje publike, realizoi punësimin e 4 (katër) nëpunësve gjyqësorë, edhe atë 3 (tre) nëpunës profesionalë gjyqësorë me pozitë bashkëpunëtor i lartë gjyqësor, bashkëpunëtor i ri gjyqësor dhe këshilltar gjyqësor, si dhe 1 (një) ndihmësnëpunës profesional gjyqësor me pozitë referent i ri gjyqësor-zbatues në arkiv.

Gjatë nëntorit të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi pa shpallje publike, me anë të transferimit të përhershëm, realizoi punësimin e 1 (një) pjesëtari të policisë gjyqësore nga Gjykata Themelore Civile Shkup.

Gjatë dhjetorit të vitit 2019, Gjykata Administrative, me procedurë punësimi me shpallje publike, realizoi punësimin e 1 (një) ndihmësnëpunësi gjyqësor me pozitë referent – kontabilist i pavarur gjyqësor.

Gjatë vitit 2019, një nëpunësi gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Gjykatën Administrative për shkak të përmbushjes së kushteve të pensionimit, edhe atë referent i lartë gjyqësor-zbatues në arkiv.

Gjatë vitit 2019, 6 (gjashtë) personave me të cilët është lidhur kontratë punësimi me kohë të caktuar (përfshirë 31.12.2019), u është ndërprerë marrëdhënia e punës në Gjykatën Administrative, edhe atë një bashkëpunëtorit të lartë gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës më datën 2.7.2019, një bashkëpunëtorit të ri gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 4.9.2019, një referentit gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 4.9.2019, një referentit të ri gjyqësor (zbatues në arkiv) i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 2.7.2019 dhe shoferit i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 31.8.2019.

Në vitin 2020 nevojiten të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punësime të nëpunësve gjyqësorë: nëpunës profesional gjyqësor, nëpunës administrativ gjyqësor në arkiv dhe daktilografë, me qëllim që Gjykata Administrative në tërësi ta kryejë funksionin që e ka në bazë të rregullave.

Objekti administrativ, hapësira administrative ku është e akomoduar Gjykata Administrative dhe i kryen punët dhe detyrat në kompetencë të saj në rr. “Orce Nikolov” pn Shkup, dhe është pronë e SHA Posta e Maqedonisë Shkup, dhe të njëjtën Gjykata e shfrytëzon në bazë të Kontratës për marrje me qira të lidhur mes SHA Posta e Maqedonisë Shkup, qiradhënës, dhe Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë, qiramarrës.

Me Vendimin për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të gjërave të patundshme të Gjykatës Administrative, nr. 44-8928/1 më 25.9.2018, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Gjykatës Administrative i janë dhënë për shfrytëzim të përhershëm pa kompensim, gjëra të patundshme – objekte, që gjenden në rrugën “Dame Gruev” nr. 28 të PK nr. 13479 për KK Qendër 1 dhe Fletëpronësisë nr. 103028 KK Qendër 1, në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Gjatë vitit 2019, është zbatuar procedurë për përshtatje të brendshme, riparim dhe rindërtim të objektit të ri, që sipas veprimit të punës dhe kompetencave të Gjykatës Administrative është e domosdoshme t’i përmbushë të gjitha kushtet e parapara dhe të nevojshme për funksionimin e gjykatës.

Pas dhënies së objektit, që në vitin 2018 Gjykata Administrative ka zbatuar procedurë të furnizimit publik për shërbime – përpunim të dokumentacionit projektues, si dhe procedurë të furnizimit publik për shërbimeve – revizion i dokumentacionit projektues. Projekti i përshtatjes së brendshme me rinovim të objektit ekzistues – ndërtesës dhe raporti për kontroll teknik – revizion të projektit bazë, janë përgatitur dhe i dorëzuar Gjykatës Administrative. Pas dorëzimit të projektit të rishqyrtuar, është zbatuar procedurë e furnizimit me gjëra, rinovim me përshtatje të brendshme, procedurë për të cilën janë siguruar mjete në vlerë prej 30.000.000,00 denarë me Vendimin nr. 01-197/33 datë 31.1.2019 për sigurimin e mjeteve për shpenzime kapitale të njësisë, shfrytëzues të buxhetit për pushtetin gjyqësor për vitin 2019, i miratuar nga Këshilli Gjyqësor Buxhetor, duke pasur parasysh që oferta më e volitshme gjatë procedurës ka vlerë prej 51.682.622,47 denarë me shkresë të datës 3.6.2019, Gjykata Administrative iu drejtua me një kërkesë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të gjendet një mënyrë dhe të bëhen përpjekje për risigurimin e mjeteve për realizimin e plotë të marrëveshjes kornizë. Nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut jemi informuar se ka vullnet të sigurohen mjetet për realizimin e plotë të marrëveshjes kornizë, por mjetet do të na ndahen në momentin kur do të fillojnë aktivitetet ndërtimore.

Krahas të gjitha veprimeve të ndërmarra nga Gjykata Administrative, për sigurimin e të gjitha kushteve për rinovimin e objektit, si dhe sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për rinovimin e objektit, Gjykata edhe më tej nuk mund ta marrë këtë në zotërim, për shkak se një pjesë e shërbimeve të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve edhe më tej e shfrytëzojnë objektin dhe nuk mund të fillohet me aktivitete të ndërtimit. Gjykata Administrative është drejtuar me shkrim deri tek institucioni i Avokatit Shtetëror

për të ndërmarrë masa konkrete për shpërnguljen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, por në përgjigje vetëm u informuam se ministria përkatëse edhe më tej nuk është shpërngulur për shkak se pjesa financiare dhe teknike e procedurës për rinovimin dhe mbindërtimin e objektit të Ministrisë, që gjendet në rr. “Crvena Skopsko Opshtina” nr. 4, janë në fazën përfundimtare dhe ata ende nuk kanë leje për përdorimin e objektit. Avokati Shtetëror nuk ka ndërmarrë masa të tjera konkrete. Me këtë pamundësohet kryerja e punëve ndërtimore-zejtare për rinovimin dhe përshtatjen që janë të domosdoshme, duke pasur parasysh që objekti është ndërtim më i vjetër dhe në masë të madhe i amortizuar.

Me shkresat e datës 21.5.2019 dhe 8.8.2019, Gjykata Administrative i drejtuar Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që të ndërmerren aktivitete përkatëse për tejkalimin e problemit me të cilin ballafaqohemi. Njëkohësisht, Gjykata Administrative u është drejtuar të gjitha institucioneve të rëndësishme, me kërkesën që të ndërmerren masa konkrete për shpërnguljen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe lirim të objektit, përkatësisht të gjendet mënyrë për tejkalimin e gjendjes së krijuar, për shkak se, nëse kjo nuk bëhet, atëherë seriozisht do të vihet në pikëpyetje zbatimi i Ligjit për Konteste Administrative (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 96 më 7.5.2019), i cili duhet të fillojë të zbatohet prej 25 majit 2020.

Për realizimin e Programit do të përkujdeset Kryetari i Gjykatës, gjykatësit, nëpunësit gjyqësorë dhe punonjësit tjetër në Gjykatë.

KRYETARI I GJYKATËS

Në veprimtarinë dhe kompetencën funksionale të kryetarit të Gjykatës janë lëndët e administratës gjyqësore, edhe atë: “AGJ”; “AGJ-01”; “AGJ-01”; “AGJ-02”; “AGJ-03”; “AGJ-04”; “AGJ-05”; “AGJ-MARR”; “AGJ-BES”; “AGJ-TEP-BES”; “REGJ” dhe “RIL”.

Gjatë vitit 2019, deri në momentin e miratimit të Programit, në regjistrin “AGJ”, janë të evidentuara 2250 lëndë, në regjistrin “REGJ” 745 lëndë, ndërsa në regjistrin “RIL” 38 lëndë, pas çka krahasuar me numrin e kërkesave që janë evidentuar në regjistrat e përmendur gjyqësorë, numri i pritur i lëndëve të reja në vitin 2019, që do të evidentohen në regjistrat “AGJ”, do të ishte 2500 lëndë, në regjistrin “REGJ”, 1000 lëndë, ndërsa në regjistrin “RIL” 45 lëndë.

Kryetari i Gjykatës Administrative, si gjykatës i kësaj gjykate, nuk do të veprojë dhe nuk do të marrë vendim lidhur me lëndët e shpërndara nëpërmjet sistemit të digjitalizuar për shpërndarjen e lëndëve – AKMIS, në Njësinë e specializuar gjyqësore për çështje financiare, furnizime publike dhe të drejta tjera të ngjashme, lëndë të cilat janë shpërndarë automatikisht përfshirë datën 31.8.2018, duke pasur parasysh se Kryetari i

Gjykatës është përjashtuar nga pranimi i lëndëve të reja, që prej datës 1.9.2018, në bazë të vendimit të veçantë të marrë. Njëkohësisht, lëndët e Kryetarit të Gjykatës të cilat janë shpërndarë dhe janë të pazgjidhura, me vendim për rishpërndarjen e lëndëve, do të rishpërndahen te gjykatësja Violeta Bogojevska, e cila prej datës 27.12.2019 vazhdon ta kryej funksionin gjykatëse e Gjykatës Administrative, në bazë të Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 02-2067/3 datë 19.12.2019, me të cilin shfuqizohet Vendimi për lënie pezull të funksionit gjyqësor të gjykatësit në Gjykatën Administrative, nr. 07-2220/1 datë 30.12.2019.

Njëkohësisht, Kryetari i Gjykatës Administrative, si gjykatës i kësaj gjykate, nuk vepron dhe nuk merr vendime për lëndët që do të evidentohet në Gjykatën Administrative, për paditë që dalin nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, e duke pasur parasysh obligimet e vërtetuara të kryetarit të Gjykatës Administrative, në bazë të Ligjit për Gjykatat, në aspekt të organizimit të punës së gjykatës dhe ndërmarrjes së masave për kryerjen e rregullt dhe në kohë të punëve në gjykatë, në përputhje me Rregulloren e Gjykatës, në drejtim të përmirësimit të fotografimit, inçizimit dhe paraqitjes publike, e sidomos në raport me informimin në kohë të opinionit për punën e gjykatës gjatë procedurës së mbrojtjes së të drejtës së votuesve.

PUNA SIPAS LËNDËVE

Në periudhën e shënuar me këtë program, puna e Gjykatës Administrative do të realizohet në suazat e tri njësive të specializuara gjyqësore, në bazë të nenit 12 të Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 58/06, nr. 35/2018, 150/10, 83/18 dhe 198/18), edhe atë:

I – NJËSIA E SPECIALIZUAR GJYQËSORE PËR FUSHËN PRONËSORE-JURIDIKE, DENACIONALIZIM, URBANIZËM, NDËRTIMTARI DHE TË DREJTA TJERA TË NGJASHME

Në suazat e kësaj njësie formohet këshill i cili vepron dhe vendos për lëndë nga fusha pronësore-juridike dhe të drejta tjera të ngjashme, dhe i njëjti vendos për ndarjen e tokës ndërtimore; tjetërsimin e tokës ndërtimore; regjistrimin në kadastrën e patundshmërive; masat e mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e marrëdhënieve të punës në fushën e arsimit; kompensimin për shfrytëzim e tokës ndërtimore; marrjen e së drejtës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore; të drejtën parësore të shfrytëzimit të tokës ndërtimore; transformimin e të drejtës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore; vërtetimin e përmbajtjes së patundshmërive; mbështetjen financiare për zhvillim rural; heshtjen e administratës nga fusha e mbështetjes financiare për zhvillim rural, sport. përplasjen e interesave dhe korrupsionin, paditë e shlyeshme, shkeljet nga fushat e ndryshme; shkarkimin nga funksioni dhe detyra nga fusha e njësisë-këshillit, certifikatat (licencat) nga fusha e njësisë-këshillit, ekspertët e fushës së njësisë-këshillit,

subvencionet nga fusha e njësisë-këshillit, dhënien e provimit për inspektor nga fusha e njësisë-këshillit dhe marrëveshjet administrative nga fusha e njësisë-këshillit.

Në suazat e kësaj njësie formohen dy këshilla të cilët do të veprojnë dhe do të vendosin për lëndët nga fusha e denacionalizimit, urbanizmit, ndërtimtarisë dhe të drejtat e tjera të ngjashme, dhe të njëjtët do të vendosin për denacionalizim; rishpronësim dhe baza tjera administrative; shpronësim; transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror; regjistri qendror; shkelje në fusha të ndryshme; shkarkim nga funksioni dhe detyra nga fusha e njësisë-këshillit; shkarkim nga detyra në organet e vetëqeverisjes lokale, veterinarit; pëlqim për ekonomi ujërash; aviacion; komunikime elektronike; mjedis jetësor (ku përfshihen mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë natyrore, subvencionet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor – peletat); ndërprerje të ndërtimit; veprimtari komunale; legalizim; transport linjor; masa të mbikëqyrjes së inspektimit në bujqësi; masa të mbikëqyrjes së inspektimit, masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e transportit linjor; masa të mbikëqyrjes nga fusha e miratimit për rindërtim; ridestitim, përshtatje; masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e veterinarisë; masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e veprimtarisë komunale; masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e mjedisit jetësor; masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e gjuetisë; masa të mbikëqyrjes së inspektimit nga fusha e prishjes së ndërtimit, objektit, objektit të përkohshëm, vendim për shkëputje të kontratës së qirasë; miratim për kryerjen e veprimtarisë; trafik hekurudhor; miratim për ndërtim; miratim për rindërtim, ridestitim, përshtatje; miratim për përdorim të objektit; prishje të objektit, objekt i përkohshëm; kthim të mjeteve nga subvencionet; ndërprerje të ndërtimit, radiodifuzion, vendim për kushte të lokacionit, banesor; peshkim; masa urbane të sanimit; prishje të objektit; pylltari; kthimi i mjeteve dhe normë interesi nga fusha e njësisë-këshillit; mbrojtjen e përmendoreve dhe trashëgimisë kulturore; kulturë; (veprimtari filmi); ekspertë nga fusha e njësisë-këshillit; shfrytëzim të parkingjeve; shkelje në fusha të ndryshme; shkarkim nga funksioni dhe detyra nga fusha e njësisë-këshillit; certifikata (licenca) nga fusha e njësisë-këshillit; subvencione nga fusha e njësisë-këshillit; dhënie të provimit për inspektorë nga fusha e njësisë-këshillit dhe kontrata administrative dhe kontrata administrative nga fusha e njësisë-këshillit.

II – NJËSIA E SPECIALIZUAR GJYQËSORE PËR PENSIONE, TË DREJTA NGA SIGURIMI PENSIONAL DHE INVALIDOR, DOGANA, FURNIZIME PUBLIKE, KONCESIONE, PARTNERITETE PUBLIKO-PRIVATE DHE TË DREJTA TË TJERA TË NGJASHME

Në këtë njësi formohet këshill që do të veprojë dhe vendosë për lëndë nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera të ngjashme dhe i njëjti do të vendosë për kujdesin dhe akomodimin e fëmijëve; shtesës së fëmijëve; baza të tjera administrative; ndihmë të njëhershme; pension bujqësor; pension invalidor; shërim në vend dhe jashtë vendit; ndihmë invalide ushtarake

në kohë paqeje; masa mbikëqyrëse të inspektorit të punës; kompensim të rrogës për orar të shkurtuar të punës për shkak të kujdesit të fëmijës me pengesë fizike dhe intelektuale; kompensim të shpenzimeve për shërim jashtë vendit; kompensim për barna dhe pajisje ndihmëse mjekësore; shuma më e ulët e pensionit; shuma e re e pensionit; kompensim në të holla për dëmtim fizik; ndihmë dhe përkujdesje ndaj personit tjetër; të drejta nga sigurimi i obligueshëm shëndetësor; të drejta nga mbikëqyrja shëndetësore-sanitare dhe kontrolli; të drejta të mbrojtjes shëndetësore; të drejta për ndihmë në të holla për nënën e cila ka lindur fëmijën e katërt; kontribute për kompensim pensional dhe invalidor, kontribute për sigurim shëndetësor; organizatë private shëndetësore; rehabilitim profesional; shtesë për humbjen e dëgjimit dhe mobilitetit; sistemimin e punëve tjera përkatëse; rikualifikim; kualifikim shtesë dhe të drejtë për kompensime të tjera; pension familjar; akomodim në Entin e rehabilitimit të personave me vonesa në zhvillim; ndihmë sociale; pensioni i moshës; tutori; harmonizim të pensionit; vërtetim të stazhit të sigurimit- stazh pensioni; shkelle në fusha të ndryshme; shkarkim nga funksioni dhe detyra nga fushat e njësisë-këshillit; certifikata (licenca) nga fusha e njësisë- këshillit; subvencione nga fusha e njësisë- këshillit; dhënien e provimit për inspektor nga fusha e njësisë- këshillit dhe kontrata administrative nga fusha e njësisë- këshillit.

Në suazat e kësaj njësie formohet këshill që do të veproj dhe vendos për lëndë nga fusha e doganave, furnizimeve publike, koncesioneve, partneriteteve publiko-private dhe të drejtave tjera të ngjashme dhe i njëjti do të vendosë për të drejtat autoriale; akciza, çështje bankare; automjetet; shtetësia; baza tjera administrative, energjetike; vendbanime; taksë komunale; koncesione dhe partneritete publiko - private; evidenca amzë; mbrojtja; armët; dokumentet e udhëtimit; të drejtat nga pronësia industriale; kundërvajtje nga fusha e doganave; akomodim; statusi i emigrantit-azil; taksa gjyqësore; letrat me vlerë; doganat; subjektet afariste; ekzekutimi i sanksioneve; kthimi i mjeteve dhe normës së interesit nga fusha e njësisë- këshillit; avokatë; ndërmjetësit; lojërat e fatit, informacione të klasifikuara, mbrojtja e të dhënave personale, shkarkimi nga detyra, ekonomia, përmbaruesit, noterët, qasja deri tek informacionet me karakter publik, prokurorët (ndërprerje dhe shkarkim nga funksioni prokuror dhe kandidatë për dhënien e provimit të jurisprudencës); furnizime publike, ndihmë juridike falas, ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, shkarkim nga detyra-bartës i funksionit publik, kundërvajtje nga fusha të ndryshme; shkarkim nga funksioni dhe detyra nga fusha e njësisë-këshillit; certifikata (licenca) nga fusha e njësisë-këshillit; subvencione nga fusha e njësisë-këshillit; dhënien e provimit për inspektor nga fusha e njësisë-këshillit dhe kontrata administrative nga fusha e njësisë-këshillit.

III – NJËSIA E SPECIALIZUAR GJYQËSORE PËR ÇËSHTJE FINANCIARE DHE TË DREJTA TË TJERA TË NGJASHME

Në këtë njësi formohen tre këshilla që do të veprojnë dhe vendosin për lëndë nga fusha e tatimit personal; tatimit të fitimit; tatimit të vlerës së shtuar; tatimit të pronës; tatimit të qarkullimit; tatimit të trashëgimisë dhe dhuratës; evidentimin dhe të drejtat në bazë të papunësisë; verifikimin e fakteve; kompensimin në bazë të papunësisë; shkelje nga fusha e tatimeve; pagesë të detyrueshme (këtu bëjnë pjesë pagesa e detyrueshme e taksës së radiodifuzionit dhe pagesa e detyrueshme e taksës komunale); Marrëdhëniet e punës; çështjet financiare nga fusha e sportit; e drejta e pagës pas ndërprerjes së funksionit (apanazh); financimin e partive politike; kthimin e mjeteve dhe normës së interesit; shkelje në fusha të ndryshme; shkarkimin nga funksioni dhe detyra nga fusha e njësisë-këshillit (nga fusha e financave); certifikata (licenca) nga fusha e njësisë-këshillit; subvencionet nga fusha e njësisë-këshillit; dhënia e provimit për inspektorë nga fusha e njësisë-këshillit; dhe marrëveshje administrative nga fusha e njësisë-këshillit.

Njëkohësisht, termi “furnizime publike”, duke filluar nga data 1.3.2020, nga III-Njësia e specializuar gjyqësore për çështje financiare dhe të drejta tjera të ngjashme, do të zhvendoset në Këshillin që do të veprojë dhe vendosë për lëndë nga fusha e doganave, furnizimeve publike, koncesioneve, partneriteteve publiko-private dhe të drejtave tjera të ngjashme në suazat e II – Njësia e specializuar gjyqësore për pensione, të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor, dogana, furnizime publike, koncesione, partneritete publiko-private dhe të drejta të tjera të ngjashme.

Nëse pranë Gjykatës Administrative evidentohet kontest administrativ, për çështje e cila me këtë program nuk është e përcaktuar në kompetencë të njërive të specializuara, e njëjta do të regjistrohet në Regjistër – Lëndë të Ndryshme Administrative (LNA).

Në Regjistër-LNA-regjistrohen edhe lëndët e “të drejtës zgjedhore”, që kanë të bëjnë me Kodin Zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/2006; 136/2008; 148/2008; 155/2008; 163/2008; 44/2011; 51/2011; 142/2012; 31/2013; 34/2013; 14/2014; 30/2014; 196/15; 35/16; 97/16; 99/16; 136/16, 142/16, 127/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19) si dhe lëndë kundër vendimeve të Komisionit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit, sipas Ligjit për Pengimin e Korrupsionit dhe Përplasjes së Interesave (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 12/19), të miratuara në lidhje me nenin 8-a, 8-b dhe 8-c nga Kodi Zgjedhor.

Në Regjistër-LNA-regjistrohen edhe lëndët që kanë të bëjnë me ligjin për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr. 59/00, 26/01, 13/03, 55/05, 37/06, 115/07, 19/08, 82/08,

10/10, 51/11, 15/13, 139/14, 196/15, 142/16, 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 98/19).

Duke pasur parasysh që gjatë vitit 2018, në këtë gjykatë janë regjistruar dhe formuar gjithsej 7723 lëndë të reja të normuara, ndaj të cilave veprohet në këshillat në suazat e njësive të specializuara gjyqësore, numri i pritur i lëndëve të reja në vitin 2019 do të ishte rreth 8000.

PËRGATITJA E ANALIZAVE, INFORMACIONEVE, SUGJERIMEVE DHE KONTROLLEVE PËRMBLEDHËSE

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së punës, në Gjykatën Administrative në vitin 2019 do të përpilohen analiza, informacione dhe sugjerime me kontrole konkrete varësisht nga aktualiteti i çështjeve të caktuara juridike, çështjeve në punë, ndërsa gjithashtu gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor në vitin vijues, sipas nevojës, do të përpunojnë materiale për këshillim, nga fusha e caktuar, pas çka në njësinë përkatëse do të përcaktohen temat dhe personat që do t'i përpunojnë si dhe koha e mbajtjes së këshillimit, ndërsa materiali do të duhet të verifikohet në njësinë përkatëse, për çka kryetarët e këshillave në suazat e njësisë, do ta informojnë kryetarin e Gjykatës.

Gjatë vitit 2020 do të përgatiten kontrole përmbledhëse dhe informacione për punën sipas parashtresave dhe propozimeve në vitin vijues, për qarkullimin dhe zgjidhjen e lëndëve në Gjykatën Administrative dhe për gjendjen me zgjidhjen e lëndëve të vjetra.

PRAKTIKA GJYQËSORE

Formohet një këshill për praktikë gjyqësore, i cili do të veprojë dhe përpunojë përmbytje të ndryshme që përfshijnë vendime të Gjykatës Administrative, vendime të Gjykatës së Lartë Administrative dhe sentenca të nxjerra nga këto vendime, për rastet karakteristike që mund të jenë në dobi të gjykatësve gjatë veprimit me lëndë tjera të njëjta ose të ngjashme dhe gërshetimi i praktikës gjyqësore, më pas në vazhdimësi do të ndiqen të gjitha ndryshimet ligjore, qëndrimet parimore, mendimet dhe konkluzionet e Gjykatës Supreme që zbatohen në praktikën gjyqësore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese që janë të rëndësishme për lëndët me të cilat vepron Gjykata Administrative, përfshirë këtu vendimet e marra nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

LËNDË TË VJETRA DHE ME PRIORITET

Kryetari i Gjykatës Administrative e ndjek punën e gjykatësve, si dhe gjendjen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, nga afër dhe përmes sistemit AKMIS, si dhe nëpërmjet Trupit të Punës për Menaxhim me Lëndët.

Trupi i Punës për Menaxhim me Lëndët, propozon masa për zgjidhjen e lëndëve të vjetra dhe përpilimin e planeve për zgjidhjen e lëndëve të vjetra. Kryetarët e këshillave do të mblidhen çdo muaj për zgjidhjen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura.

Gjykatësit të dorëzojnë raport me shkrim për lëndët e vjetra të pazgjidhura, duke theksuar arsyet e moszgjidhjes dhe të bëjnë plan personal për periudhën kohore në të cilën lëndët do të zgjidheshin gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2019, lëndët e vjetra të sapo pranuar janë 259, ndërsa gjatë vitit 2018 lëndët e vjetra të sapo pranuar janë 339, që nënkupton se në vitin 2019 numri është ulur për 33 për qind. Për këtë arsye, në qarkullim në vitin 2019 ka 384 lëndë të vjetra, ndërsa në vitin 2018, 482 lëndë të vjetra. Për këtë arsye, në vitin 2020 do të vihet theks i veçantë tek ulja e pjesës së mbetur për 37 lëndë të vjetra të pazgjidhura, që kanë mbetur në fund të vitit 2019, nga të cilat 19 lëndë janë reregjistruar për shkak të shfuqizimit të pesë lëndëve për arsye të procedurës së përsëritur.

TAKIME DHE KËSHILLIME

Për shkak të përsosmërisë profesionale, gjykatësit dhe punonjësit gjyqësorë në Gjykatën Administrative si dhe të punësuarit e tjerë në administratën gjyqësore do të marrin pjesë në këshillim, seminare dhe trajnime tjera, që do t'i organizojnë Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik, gjykatat, Shoqata e Gjykatave, organet e shtetit dhe Organizata dhe Asociacione të huaja. Më pas, vendim për këshillimet dhe seminarët do të sjellë kryetari i Gjykatës dhe kryetarët e njësive përkatëse, varësisht nga rëndësia e çështjeve që do të jenë temë këshillimi, ndërsa të gjithë kanë të drejtë për përsosmëri të barabartë profesionale.

FORMA TË TJERA TË PUNËS

Të punësuarit në administratën gjyqësore punën do ta realizojnë në kuadër të detyrave të tyre, të parapara me aktet e Gjykatës dhe ajo që do t'u besohet gjatë punës nga ana e kryetarëve të Gjykatës dhe nëpunësit gjyqësor.

Çdo i punësuar në administratën gjyqësore obligohet të dorëzojë raport dymujorë për punën e tij, ku do t'i evidentojë punët e kryera gjatë muajit, e të cilat do të shërbejnë gjatë vlerësimit të punës së tij.

Policia gjyqësore, me të cilën udhëheq kryetari i Gjykatës Administrative, është e obliguar të kryejë sigurimin e godinës së Gjykatës, njerëzve dhe lëndëve, dhe të trajnohet në mënyrë teorike dhe praktike në përputhje me planin e kryetarit të Gjykatës.

Gjatë vitit 2020, në vazhdimësi do të përditësohen të dhënat për ueb-faqen e Gjykatës.

Nga data 1.1.2018, në funksion është ueb-faqja e Gjykatës Administrative, ku publikohen të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me me punën e Gjykatës.

Gjatë vitit, Programi në mënyrë shtesë do të plotësohet sipas dukurive të paraqitura pozitive apo negative, për shkak të rritjes së efikasitetit dhe përditësimit të gjykatës.

KRYETARI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE,

Burim Sejdini

